



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



# Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale

Furnizuesi me Shërbim Universal

Viti relevant tarifor 2018

## DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

**13 shtator 2018**



## Përmbajtja

Hyrje.....	3
1 Bilanci i energjisë elektrike 2018 .....	4
2 Kostot me shumice - blerjet e energjisë .....	5
3 Përshtatjet e vitit 2016 dhe 2017 .....	6
3.1 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2016 .....	6
3.2 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2017 .....	6
4 Kostot e bartshme.....	8
5 Kostot me pakicë të furnizuesit .....	8
TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE .....	9



## Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është duke kryer procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e dytë rregullative për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut OST/OT (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSh (KEDS). Ky proces nënkupton parashikimin e komponentëve të kostove për këta të licencuar për periudhën 2018-2022. Këto kosto të cilat njihen si kosto të bartshme janë bazë për përcaktimin e të hyrave, respektivisht tarifave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) - KESCO.

Ndryshe nga shqyrtimet paraprake gjatë procesit të përcaktimit të të hyrave të lejuara të furnizuesit, ZRRE ka marr parasysh edhe kostot e furnizimit me energji elektrike nga Gjeneratori Publik KEK, duke qenë se të hyrat dhe tarifat e Gjeneratorik Publik KEK nuk aprovohen nga ZRRE pas hyrjes në fuqi të pakos së tretë të ligjeve.

Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së për propozimin për hyrat e lejuara maksimale (MAR) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për vitin relevant tarifar 2018. Në mungesë të arritjes së marrëveshjes për furnizim me energji elektrike ndërmjet KEK Sh.A dhe KESCO, ZRRE nuk ka aprovuar të hyrat e lejuara maksimale për KESCO për vitin 2017, por ka aprovuara vetëm tarifat me pakicë, respektivisht strukturën e re tarifore, bazuar në tarifat mesatare të aprovuara për vitin 2016. Ky mos aprovim i MAR për KESCO-në për vitin 2017, do të thotë se edhe përshtatjet e nevojshme për vitin 2016 nuk janë aplikuar. Për të mbuluar këtë zbrastësirë (përshtatjet e vitit 2016), ZRRE me datën 12 maj 2017 ka njoftuar KESCO-në se përveç përshtatjeve të vitit 2017, gjatë përcaktimit të MAR-it të vitit 2018 do të inkorporohen edhe përshtatjet e vitit 2016.

Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në formë elektronike përmes emailit në [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) ose të dorëzohen në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji  
Departamenti për Tarifa dhe Çmime  
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12  
Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është 27 shtator 2018.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, ZRRE-ja do të publikojë **Raportin Final së bashku me përgjigje ndaj komenteve.**



## 1 Bilanci i energjisë elektrike 2018

Bilanci i energjisë elektrike i parashikuar për Furnizuesin me Shërbim Universal rezulton nga bilanci nacional i rishikuar pas komente të dhëna nga ZRRE. Në përcaktimin e të hyrave të FSHU është marr parasysh bilanci i cili duhet të reflektojë vetëm kostot e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Në këtë kuptim edhe volumet për blerjet e energjisë me shumicë për FSHU janë:

- Blerjet e energjisë nga KEK SH.A;
- Blerjet e energjisë nga gjeneratorët e kyçur në nivel të transmetimit;
- Blerjet e energjisë nga gjeneratorët e kyçur në nivel të shpërndarjes; dhe
- Importi.

Sasia e energjisë për eksport gjatë këtij parashikimi nuk është konsideruar si energji e FSHU-së, pasi që FSHU duhet të nominojë vetëm sasi të nevojshme për mbulimin e konsumit të konsumatorëve me shërbim universal. Kjo sasi e energjisë duhet të menaxhohet nga prodhuesi përkatës në pajtim me prioritetet e dispeçimit. Konsumi i konsumatorëve me shërbim universal ka të përfshira të gjitha kategoritë e konsumatorëve përveç konsumatorëve të kyçur në nivel të transmetimit. Në tabelën në vijim janë dhënë burimet e furnizimit për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve të FSHU-së.

**Tabela 1: Bilanci i energjisë elektrike për FSHU**

Blerjet e energjisë	GWh
Sasi të furnizuara nga KEK	2,968
Ujmani dhe gjeneratorë tjerë në nivel të OST	200
Gjeneratorët në nivel të OSSh-së	105
Importi	150.0
<b>Total sasi të furnizuara</b>	<b>3,423</b>
<b>Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve FSHU</b>	
Konsumatorët 35 kV	41
Konsumatorët 10 kV	311
Konsumatorët 0.4 kV	3,071
<b>Total konsumi i konsumatorëve të FSHU</b>	<b>3,423</b>

Siç shihet nga tabela, sasia e energjisë që planifikohet të konsumohet nga konsumatorët me drejtë të shërbimit universal është e barabartë me sasi të duhet të mbulohen nga burimet e ndryshme të furnizimit.

*Shënim: Sasia nevojshme për tu furnizuar nga KEK SH.A është kalkuluar si diferencë e sasisë totale ndaj burimeve tjera të furnizimit, duke marr parasysh se këto burime të furnizimit janë burime të ripërtrishme të energjisë dhe kanë prioritet në dispeçim.*

Mbulimi i humbjeve në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjësi e operatorëve të rrjeteve përkatëse dhe ato nuk janë paraqitur në këtë tabelë. Trajtimi i tyre është bërë në Raportet Konsultative për MAR-et e OST/OT-së dhe OSSh-së.



## 2 Kostot me shumice - blerjet e energjisë

Pas përcaktimit të sasive të nevojshme për furnizim me qëllim të mbulimit të kërkesave të konsumatorëve të FSHU-së, duhet të bëhet edhe kalkulimi i kostove për blerje të energjisë në tregun me shumicë. Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të sigurojë energji elektrike në mënyrë transparente, konkurruese dhe efikase. Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet të demonstrojë se çmimet e parashikuara të energjisë elektrike që do të prokurohen janë të arsyeshme.

Gjatë procesit të negocimit të kontratave për blerje të energjisë të FSHU-së nga gjenerimi vendor duhet pasur parasysh faktin se çmimet e parashikuara janë në përputhje me çmimet historike dhe ato të projektuara në tregun me shumicë të Kosovës.

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ( $WHPC_t$ ) duhet të llogariten sipas formulës:

$$WHPC_t = (GENC_t + IMPC_t + IMBC_t * IMBF_t) * (1 + RETM_t)$$

Ku:

$GENC_t$  Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë në vitin relevant  $t$

$IMPC_t$  Kostot e lejuara të energjisë së importit në vitin relevant  $t$

$IMBC_t$  Kostot neto të imbalancit në vitin relevant  $t$

$IMBF_t$  Faktori ndarës i imbalancit në vitin relevant  $t$

$RETM_t$  Marzha me pakicë në vitin relevant  $t$

Duke qenë se gjatë vitit 2017 kostot neto te jobalanceve pas programit te kompensimit rezultojnë neto pozitive ato do të përshtaten në përcaktimin e të hyrave në vitin 2018. ZRRE në parashikimin e kostove të blerjes së energjisë për vitin 2018 nuk konsideron ndonjë kosto apo të hyrë (pro-ante) nga jobalancet, në rast të realizimit të kostove apo të hyrave gjatë vitit 2018, ZRRE ato do ti trajtojë në vitin 2019 (ex-post).

Përmbledhja e kostove me shumicë të parashikuara për vitin 2018 është dhënë në tabelën në vijim:

**Tabela 2: Blerjet e energjisë**

Kostot e blerjes së energjisë	GWh	€/MWh	€'000
Sasitë e furnizuara nga KEK	2,868	29.00	83,180
Ujmani dhe gjeneratorë tjerë në nivel të OST	200	32.44	6,488
Gjeneratorë në nivel të OSSh-së	105	36.68	3,854
Importi	250.0	55.00	13,750
Kostot e jobalanceve		-	-
Faktori ndarës i jobalanceve		-	-
<b>Total sasitë e furnizuara</b>	<b>3,423</b>	<b>32.28</b>	<b>107,272</b>
Margjina me pakicë		3.00%	3,218
<b>Total kostot e blerjes së Energjisë</b>			<b>110,490</b>



### 3 Përshtatjet e vitit 2016 dhe 2017

#### 3.1 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2016

Përshtatjet e vitit 2016 është dashur të bëhen gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara për FSHU-në për vitin 2017, mirëpo për duke qenë se për vitin 2017 FSHU dhe KEK nuk kanë arritur marrëveshje për shit-blerje të energjisë, si rrjedhojë edhe përshtatjet e vitit 2016 nuk kanë mundur të aplikohen. Me qëllim që nga ky mos aprovim i MAR-it të mos ketë edhe pezullim të tarifave, që do të ndikonte në probleme eventuale të tërë sektorit të energjisë, ZRRE ka bërë zgjidhjen e nevojshme ashtu që tarifat mesatare të aprovuara për vitin 2016 të aplikohen në vitin 2017 sipas strukturës së re tarifore.

Bazuar në atë që u tha më lartë për përcaktimin e të hyrave të lejuara për vitin 2018 për FSHU-në, përveç përshtatjeve të vitit 2016 duhet aplikuar edhe përshtatje e vitit 2017 si përshtatje të rregullta vjetore. Në tabelën në vijim janë dhënë detajet e këtyre përshtatjeve:

**Tabela 3: Përshtatjet për vitin 2016**

Linja	Njësia	mil€
a) Kostot e lejuara me shumicë	mil€	167.01
b) Kostot e realizuar me shumicë	mil€	156.01
b-a Përshtatjet e kostove me shumicë	mil€	-11.01
Norma e intresit	%	7.51
Kostoja e normës së interesit	mil€	0.83
Faktori korigjues i të hyrave - FSHU	mil€	5.39
Faktori korigjues i të hyrave - OSSh	mil€	3.93
Faktori korigjues i të hyrave - OST	mil€	1.00
<b>Total</b>	mil€	<b>-1.52</b>

#### 3.2 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2017

Për të bërë përshtatjet e vitit 2017 të cilat do të aplikohen gjatë përcaktimit të MAR-it të FSHU për vitin 2018, së pari duhet të bërë vlerësimin e kostove aktuale të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e FSHU-së. Dallimi ndërmjet kostove të realizuar dhe të hyrave nga faturimi do të përshtaten në përcaktimin e të hyrave në vitin 2018.

Ndryshimi në mes të të hyrave të vlerësuara nga ZRRE-ja për vitin 2017 dhe të hyrave të realizuara nga FSHU gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$ADJ_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku janë:*

$AAC_{at-1}$  Kostot e lejuara aktuale të FSHU-së në vitin relevant t

$ARR_{t-1}$  Të hyrat aktuale të rregulluara gjatë vitit relevant t-1



$I_t$

Norma e interesit për vitin relevant  $t$ , që llogaritet bazuar në EURIBOR plus  $S\%$ , ku  $S$  paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra

Vlera e përshtatjeve për vitin 2017 pas aplikimit të normës së interesit rezulton të jetë -16.6 milion euro.

**Tabela 4: Përshtatjet për vitin 2017**

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	2017
Parametrat e indeksimit		
Norma e interesit $I_t$	%	7.4%
Kostot me pakice të furnizuesit		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.8
$Zhvlerësimi - DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.4
Kostot e bartshme		
Kostot e OST	€m	19.0
Kostot e OSSh	€m	76.1
Kapitali punues (WCLC <sub>t</sub> )		
$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.4
Kostot për blerjen e energjisë		
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	127.2
Taksa për licencë		
Taksa për licencë	€m	0.1
Borxhi i keq (BDTA)		
BDTA	%	4%
BDTA	€m	9.6
Përshtatjet e të hyrave për FSHU		
MAR-i i Furnizuesit $AAC_{at-1}$	€m	239.5
Të hyrat aktuale nga faturimi $ARR_{t-1}$	€m	256.1
<b>Përshtatja e të hyrave <math>ADJ_t</math> (përfshire normen e interesit)</b>	<b>€m</b>	<b>-17.8</b>



#### **4 Kostot e bartshme**

Kostot e bartshme të FSHU-së janë ato që varen nga vlerësimet për MAR-et për kompanitë tjera të rregulluara për periudhën rregullative 2018-2022. Këto kosto përfshijnë kostot nga KOSTT dhe KEDS (PSTCt), dhe ndonjë kosto tjetër që është jashtë kontrollit të FSHU-së. Në këtë raport kostot e bartshme për KOSTT dhe KEDS janë marr nga raportet konsultative të publikuara me datën 24 gusht 2018. Kostot e bartshme për KOSTT janë 33.6mil€, mirëpo obligimet e FSHU-së ndaj KOSTT përfshirë edhe fondin për burimet e ripërtrishme janë 25.3mil€, ndërsa kostot e bartshme për KEDS janë 80.9 mil€.

#### **5 Kostot me pakicë të furnizuesit**

Kostot e lejuara me pakicë llogariten si shuma e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMct), zhvlerësimi (DEPct) dhe ato të licencës (LCICt). Kostot e propozuara me pakicë për FSHU për vitin 2018 kanë përdorur si pikë nisje kostot e lejuara në vitin 2016 dhe të indeksuara për faktorin e efikasitetit të vitit 2016 ( apo si vlerë fillestare për vitin 2018 është opexi i vitit 2017). Vlera e kostove me pakicë për FSHU për vitin 2018 është paraparë të jetë 6.3 mil€. Komponentët tjera të kostove me pakicë siç janë marzha me pakicë, borxhi i keq dhe kapitali punues janë kalkuluar në bazë të formulave të përcaktuara në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së. Parametrat hyrës për FSHU-në janë përdorur parametrat ekzistues, këta parametra do të mbesin të njëjtë deri në shqyrtimin e ardhshëm të tyre në pajtim me periudhën e vendosjes së obligimit të shërbimit publik.





## TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE

MAR i propozuar për FSHU për vitin 2018 është 215 milion €, e cila paraqet shumën që do të mbulohet nga tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë. Detajet për MAR-in e propozuar janë dhënë në tabelën në vijim:

**Tabela 5 MAR i propozuar për vitin 2018**

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	2018
<b>Parametrat e indeksimit</b>		
Norma e interesit It	%	7.4%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.9
$Zhvlerësimi - DEPCt = DEPCt-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Pt)$	€m	0.4
<b>Kostot e bartshme</b>		
Kostot e OST	€m	20.5
Kostot e OSSh (Perfshire kostot e bartshme OST/OT)	€m	80.9
Kostot për fondin e BRE	€m	5.03
<b>Kapitali punues (WCLCt)</b>		
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	1.3
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>		
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	110.5
<b>Taksa për licencë</b>		
Taksa për licencë	€m	0.0
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>		
BDTA	%	4%
BDTA	€m	8.6
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>		
Përshtatjet e vitit 2016	€m	-1.52
Përshtatjet e vitit 2017	€m	-17.8
<b>Të hyrat e lejuara maksimale</b>	<b>€m</b>	<b>213.9</b>

Të hyrat pas aplikimi të tarifave ekzistuese rezultojnë të jenë 224mil€, që paraqet kërkesë për ulje të kostove rreth 10mil€. Kjo ulje mund ti atribuohet:

- Mos përfshirja e kostove të energjisë së pa-faturuar për furnizimin në veri të Kosovës;
- Rritje e të hyrave në vitin 2017 nga faturimi pas aplikimit të strukturës së re tarifore;
- Ulja e të hyrave nga KEK ndaj KOSTT-it;
- Si rezultat i kostove me të ulta të blerjeve me shumicë, kemi edhe ulje të kompetenteve të kostove me pakicë që derivohen nga to siç janë: margjina me pakicë, kapitali punues dhe borxhi i keq.